



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2188/2 prot.,

Datë 05.08.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Bean” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-09251-06-12-2024, me objekt: “*Ndërtim i godinës 3+1 kt, kopështi Babrru Qendër*”, me fond limit 52,841,229.78 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bean” SHPK, me NUIS J72510445Q me adresë: Lagjja Qender, prane shkolles 8 vjecare, Fier .
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz
Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Në datën 02.08.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4398, protokolluar me nr. 2188/2024 protokolli, e operatorit ekonomik “Bean” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-09251-06-12-2024, me objekt: “*Ndërtim i godinës 3+1 kt, kopështi Babrru Qendër*”, me fond limit 52,841,229.78 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Bean” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Bean” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 2188 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Ne përfundim të vlerësimit të ofertave rezultoj se ne kete procedure kane marr pjese 6 operatore ekonomik nga te cilet 4 nuk plotesojn kerkesat e vendosura ne DST dhe jane skualifikuar dhe 2 oferta te suksesshme te cilat plotesojn kerkesat e miratuara ne DST . Ofertat e suksesshme jane ofertat si meposht : 1. Bean shpk 2. Ergi shpk. Ne përfundim, ne zbatim te nenit 93 “Oferta anomalisht e ulët” te Ligjit 162\2020 “Per prokurimin publik”, nenit 82 pika 4 ku citohet se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;” te VKM 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik” si dhe nenit 27 ku citohet se “Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”. Te Ligj Nr. 16/2024 “Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Pra pas llogaritjeve aritmetike te ofertave te klasifikuar sit e susksesshme rezultoj se operatori ekonomik Bean shpk eshte oferte anomalisht e ulët pasi është nën 25% të fondit limit, ndaj ne respektim te aktveve ligjore te siperpermendura operatori ekonomik BEAN shpk SKUALIFIKOOHET..”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 05.08.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro